



# SBASHK Arsimimi sot

Qershor, 2023

Gazeta elektronike

## Vazhdohet me aktivitetin tradicional në shërbim të anëtarësisë SBASHK-u organizoi pushime për 430 anëtarë në bregdetin shqiptar



Në shenjë respekti për angazhimet në misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave edhe këtë vit SBASHK vazhdon me traditën e dërgimit të një numri të konsideruar të anëtarëve për pushime në bregdetin shqiptar. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe gjithë stafin dhe kujdestarët e angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Ky aktivitet ka nisur më 15 qershor me grupin e parë prej 164 pushuesve nga Klina, Istogu, Peja, Deçani...(faqe 3)

Në ditën botërore të eliminimit të punëve të rrezikshme për fëmijët

## Konferencë në Tiranë “Sindikatat dhe puna e fëmijëve”

Në Tiranë vazhdojnë të organizohen ...(faqe 9)

Bisedë me Ymer Ymerin,  
koordinatoren për organizim të brendshëm në SBASHK  
Një aktivitet i organizuar me sukses



Organizimi i pushimeve për ... (faqe 3)

Në Tiranë u mbajt Konferencë rajonale e sindikatave të arsimit  
Bashkë, Sindikata e Amerikës, Kosovës, Shqipërisë  
dhe Maqedonisë së Veriut



Për të forcur bashkëpunimin e SBASHK-ut, ...(faqe 5)

Qershori solli një ngjarje të veçantë për SBASHK-un  
Përfaqësues të lartë sindikal nga SHBA erdhën  
për vizitë në Kosovë



Kishin krijuar miqësi të singertë në fillimin ... (faqe 6)



## Editorial

### Përfunduar edhe një vit shkollor



Në fund të çdo viti mësimor në të kaluarën ndjehej një atmosferë feste dhe bëheshin analizat e arritjeve në përpjekjet e përbashkëta për sukses sa më të mirë në procesin mësimor. Kaluan muaj, javë e ditë të vështira e me plot sfida dhe u përmyll edhe ky viti shkollor, që konsiderohet me arsye si nga më të vështirët e i mbushur me plot telashe e sfida. SBASHK-u duke parë se po mungon plotësisht vullneti i Qeverisë për dialog dhe pas pritjeve prej 9 muajsh që të realizohen kërkesat legjitime, dëgjoi zërin e anëtarësisë dhe nisi me grevën duke mbajtur gjallë shpresën se më në fund Qeveria do ta kuptoj realisht situatën dhe do të nis me dialogun e vërtet, por kjo nuk ndodhi. Qeverisë për të fshehur dobësitë e mungesën e dijes për të qeverisur, si duket, i konvenonte greva sepse opinioni do të merrej me të dhe nuk do të shihte lëshimet, njërin pas tjetrit, të Qeverisë.

Qeveria nuk deshi ta pranoj fillimisht, por më vonë e tha

publikisht se veprimet që po bënte në shërbim të sektorit publik ishin për arsye të presionit nga greva. Qeveria me buzëqeshje ironike fliste e në heshtje kishte dhënë betimin se do të vazhdonte luftën kundër çdo zëri kundërshtues dhe do të bënte çmos për t'i zhdukur sindikatat e në veçanti SBASHK-un. Mirëpo gjithë kjo nuk ndodhi. SBASHK-u tejkaloi me urtësi e me unitet çdo goditje dhe mbeti fuqishëm në rrugëtimin që vazhdon si zë i fuqishëm i të punësuarve në arsim që nga çerdhet e deri në universitete. Ministria Nagavci me deklarata të pabazuara për Kontratën Kolektive e me vendimin e njëanshëm për zëvendësim të orëve të humbura të grevës po bënte luftë për të dobësuar SBASHK-un, por e tëra i shkoi huq. Të shtunat treguan se sa efekt pati vendimi i saj pa pyetur as Këshillin e prindërve, as DKA-të as SBASHK-un. E vetme mbeti dhe e vetmja është ajo fajtoreshë pse ndodhën dështimet të shtunave dhe ditëve të tjera që ajo kishte planifikuar për zëvendësim të orëve të humbura. Viti shkollor mbaroi dhe do të shënohet në faqet e historisë së arsimit si njëri nga vitet plot sfida. Urojmë që tani e tutje të kemi dialog, mirëkuptim e angazhime të përbashkëta se vetëm as Ministria Nagavci që ka shumë vota në Qeveri e në Parlament nuk arrijnë dot suksese. Bashkërisht kur angazhohemi sukseset nuk mungojnë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimit SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel: +383 (0) 38 226 940



## Intervista

Bisedë me Ymer Ymerin, koordinatorin për organizim të brendshëm në SBASHK  
**Një aktivitet i organizuar me sukses**



Organizimi i pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarëve nga e tërë Kosova është nga aktivitetet, që tani më është bërë tradicional. Në dukje të parë ky aktivitet duket i lehtë për t'u organizuar, por në të vërtetë ka sfida dhe duhet shumë angazhim i stafit qendror. Shumë nga pushuesit tani e sa vite shënojnë përshtypjet e tyre dhe një pjesë e tyre edhe botohen në gazetën "Arsimimi sot". Këto përshtypje shprehin natyrshëm vlerësimin e lartë të pushuesve për organizimin e shkëlqyer dhe për atmosferën e krijuar në gjithë ditët e pushimit në

bregdetin shqiptar. Për rrjedhën e këtij aktiviteti në verën 2023 flet koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.

Ai tregon se organizimi i pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut është njëri nga aktivitetet, që sindikata realizon në shërbim të anëtarësisë. Këtë vit, tregon Ymeri, nga shoqatat sindikale janë përzgjedhur 430 pushues, të cilët pastaj janë ndarë në tri grupe. Ai lavdëron angazhimin e tërë stafit qendror dhe të kryetarëve të niveli komunal sindikal dhe të universiteteve, të cilët kanë respektuar në përpikëri kriteret e përcaktuara nga organet gjegjëse të SBASHK-ut.

Duke shpalosur angazhimet me qëllim të rrjedhës së mbarë të këtij aktiviteti Ymeri tregon se në marrëveshje me Komplexin Hotelier Turistik "Bonita" e me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë pushuesit janë ndarë në tri grupe dhe ky aktivitet kishte nisur së realizuari më 15 qershor me grupin e parë për të vazhduar më 25 qershor me grupin e dytë e për ta përmbyllur këtë aktivitet me grupin e tretë më 2 korrik. Në vazhdim Ymeri shton se falë qëndrimit e sjelljeve me dinjitet të pushuesve dhe mikpritjes së pronarit dhe stafit në "Bonita" ky aktivitet ka pasur rrjedhë të mbarë dhe do të mbetet si kujtim i paharruar për gjithë pushuesit që janë përzgjedhur nga shoqatat sindikale që e kishin radhën për të qenë pjesë e këtij aktiviteti. Ymeri thotë se kryetari Jasharaj, kryesia, stafi qendror dhe gjithë pushuesit i janë mirënjohës pronarit dhe stafit të "Bonita" për mikpritjen dhe për atmosferën e krijuar në këtë pjesë të bukur të bregdetit shqiptar.

## Gjatë muajit

Vazhdohet me aktivitetin tradicional në shërbim të anëtarësisë  
**SBASHK-u organizoi pushime për 430 anëtarë në bregdetin shqiptar**



Në shenjë respekti për angazhimet në misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave edhe këtë vit SBASHK vazhdon me traditën e dërgimit të një numri të konsideruar të anëtarëve për pushime në bregdetin shqiptar.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe gjithë stafin dhe kujdestarët e angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

Ky aktivitet ka nisur më 15 qershor me grupin e parë prej 164 pushuesve nga Klina, Istogu, Peja, Deçani, Juniku, Gjakova, Rahoveci, Mitrovica, Ferizaj, Kamenica,



Suhareka, Vushtrria, Universitetet, Prishtina e Dragashi. Duke dëshmuar se SBASHK nuk i harron bashkëkombësit tonë në Kosovën Lindore në këtë aktivitet mysafirë ishin edhe 2 përfaqësues nga ato troje.



Pushuesit udhëtonin drejt bregdetit shqiptar me autobusë dhe për rrugëtimin e mbarë të tyre u kujdesen Lumnija Berisha, Tafil Peci e Marigonë Bytyqi të ndihmuar nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Respekti i veçantë nga pronarët e kompleksit turistik “Bonita” dhe i tërë stafi dhe prezantimi me dinjitet i pushuesve, që po fillonin pushimet, bashkë me muzikën e zgjedhur në mbremje, ka bërë që atmosferë e mrekullueshme të mbretëronte edhe në dy ditët e para kur moti nuk ishte krejt i favorshëm për t’u takuar me valët e qeta të detit shqiptar.



Pushuesit takoheshin me kryetarin Jasharaj duke shprehur respekt për gjithë angazhimet e tij e të stafit qendror e për të falënderuar për këtë aktivitet të qëlluar. Lumnija, Nezi, Marigona, Tafili e Hakiu vazhdonin angazhimet duke

bashkëbiseduar me pushuesit për të parë nëse ka ndonjë ankesë eventuale apo mos ka ndonjë rast që dikush mund të ketë probleme të vogla shëndetësore.



Një moment i veçantë gjatë pushimeve ishte vizita e drejtores së përgjithshme të Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington Melysa Spenber, që po shoqërohej nga drejtori i zyrës në Tiranë Steven McCloud dhe stafi i tij.



Ata kanë zhvilluar një takim përmbajtjesor me kryetarin Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe me veprimtarë sindikalë duke bashkëbiseduar për gjithë situatën aktuale e duke parë se cilat do të jenë aktivitetet e radhës për të dëshmuar respektin dhe mbështetjen e Qendrës Amerikane të Solidaritetit në Uashington dhe zyrës në Tiranë si dëshmi se ata vlerësojnë lartë angazhimet e SBASHK-ut dhe ishin e janë pranë tyre në rrugëtimin për mbrojtjen e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe në përballje me sfidat e kohës e që nuk janë të pakta për arsye të qasjes së gabueshme të Qeverisë ndaj sindikatave dhe dialogut social.



Atmosferë feste në Kompleksin Hotelier “Bonita” mbretëroi edhe nga data 25 qershor. Bukuria kësaj atmosfere iu shtua më 28 qershor. Kryetari i SBASHK-ut

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Rahman Jasharaj bashkë me koordinаторin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe përgjegjësit e angazhuar Sabit Gashi e Ahmet Sylejmani duke respektuar traditat e festës kanë shkuar nga tavolina në tavolinë dhe i kanë uruar secilit pushues festën e madhe të Kurban Bajramit.



“Festa e gëzime paçi gjithmonë. Bashkë e në SBASHK”, u është drejtuar pushuesve kryetari Jasharaj, i cili ka pranuar shumë urime dhe përgëzime për organizimin e këtij aktiviteti dhe për gjithë angazhimet e tij, të koordinatorit për organizim të brendshëm dhe gjithë stafit qendror.



Krahas respektit të lartë e meritot për SBASHK-un pushuesit e grupit të parë dhe ata të grupit të dytë shprehin falënderime edhe për pronarin e Kompleksit Hotelier “Bonita” Astritin, kryekuzhinierin Zakun dhe gjithë të punësuarit këtu, të cilët me sjellje shembullore e angazhim maksimal po bëjnë që pushuesit të ndjehen të relaksuar e të jenë shumë të kënaqur me kushtet e akomodimit dhe me ushqimin shumë cilësor.



Të theksojmë se grupin e dytë të pushuesve ishin koleget e kolegët tanë nga Mitrovica, Leposaviqi, Prishtina, Qendra e studentëve, Gjilani, Vitia, Klllokoti, Lipjani, Ferizaj, Drenasi, Suhareka, Rahoveci, Gjakova dhe Malisheva.



Ky aktivitet tradicional do të përmbyllet me grupin e tretë të pushuesve, të cilët buzë valëve të detit shqiptar filluan pushimin nga 2 korriku.



Në këtë grup janë pushues nga Fushë Kosova, Shtërpca, Shtimja, Hani i Elezit, Gjilani, Kaçaniku, Lipjani, Novobërda, Obiliqi, Podujeva, Vitia, Skenderaj, Drenasi, Malisheva, Suhareka, Gjakova, Mamusha, Peja dhe Prizreni.



Në Tiranë u mbajt Konferencë rajonale e sindikatave të arsimit

## Bashkë, Sindikata e Amerikës, Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut

Për të forcuar bashkëpunimin e SBASHK-ut, Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë e të Maqedonisë së Veriut me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës, Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdon me aktivitetet e shumta. Në kuadër të këtij angazhimi, drejtori i kësaj zyre Steven McCloud me bashkëpunëtorët kanë organizuar për tri ditë me radhë Konferencën rajonale

me përfaqësues të këtyre sindikatave. Zëvendës presidenti i Federatës Amerikane të Mësuesve Daniel Montgomery bashkë me drejtorin e kësaj Federate për rajonin perëndimor Ramiro Hernandez kanë sjellë përvojat e tyre nga mënyra e organizimit dhe e zhvillimit të aktiviteteve e veprimeve sindikale të sindikatës që ata përfaqësojnë.





Duke dhënë kontribut në rrjedhën e kësaj Konference ata janë shprehur se nga afër përcjellin angazhimet e shumta të sindikatave të këtyre tri shteteve të Ballkanit duke rikujtuar për mbështetjen e vazhdueshme të Sindikatës së Mësuesve të Amerikës për SBASHK-un dhe sindikatat e arsimit të Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut me qëllim të përballje më të lehtë me sfidat e shumta të kohës Zëvendës presidenti i Federatës Amerikane të Mësuesve Daniel Montgomery ka treguar se ata kanë përcjell me kujdes edhe angazhimet e shumta të SBASHK-ut dhe kanë shprehur solidaritet e përkrahje të fuqishme për SBASHK-un gjatë gjithë këtyre viteve e në veçanti në kohën sa po ndodhte greva e vitit të kaluar.



Përfaqësuesit e sindikatave të arsimit nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut duke marrë pjesë në panele kanë sjellë fakte e argumente për gjendjen aktuale në arsimin e shteteve të punës, për kushtet e punës në institucionet arsimore dhe për sfidat e shumta me të cilat po përballën në kuadër të angazhimeve për realizimin



e kërkesave të anëtarësisë në dialog me institucionet shtetërore, dialog ky i munguar dhe jo i lehtë. Zëvendës presidenti i Federatës Amerikane të Mësuesve Montgomery bashkë me drejtorin e kësaj Federate për rajonin perëndimor Hernandez për të dëshmuar miqësinë e singertë, që ka nismat në vitet e 90-ta, mes Sindikatës së Mësuesve të Amerikës dhe SBASHK-ut mysafirët e nderuar nga SHBA vendosen ta vizitojnë Kosovën.



## Qershori solli një ngjarje të veçantë për SBASHK-un **Përfaqësues të lartë sindikal nga SHBA erdhën për vizitë në Kosovë**

Kishin krijuar miqësi të singertë në fillimin e viteve të 90-ta Sindikata e Mësuesve të Amerikës dhe SBASHK. Mësuesit e Amerikës përmes përfaqësuesve të tyre kishin ngritur kudo zërin në mbështetje të angazhimeve e sakrificave sublime që po bënin punëtorët e arsimit të Kosovës në misionin e shenjtë të dijes e dritës përballë sulmeve të pushtuesit serb. Kjo miqësi vazhdoi edhe në vitet e pasluftës dhe përfaqësuesit e këtyre dy sindikatave kudo që takoheshin në ngjarje të rëndësishme sindikale kujtonin vitet e kaluara dhe vazhdonin me angazhimet e përbashkëta. Dëshira e SBASHK-ut që miqtë nga AFT të vizitojnë Kosovën u bë realitet në qershor.



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Zëvendës presidenti i Sindikatës së Mësuesve të Amerikës Daniel Montgomery i shoqëruar nga drejtori për rajonin perëndimor Ramiro Hernandez dhe drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë Steven McCloud nisën të mërkurën e 7 qershorit vizitën dy ditore në Kosovë.



Në ditën e parë ata fillimisht janë takuar me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri nga të cilët janë informuar për gjendjen aktuale në arsimin e Kosovës. Pas kësaj ata kanë vizituar komunën e Ferizajt dhe janë takuar me kryetarin Agim Aliu, drejtorin e arsimit Afrim Llabjani dhe udhëheqësit sindikal nga kjo komunë Hanife Salihu e Fejzullah Vranovci. Kryetari Aliu është shprehur i nderuar për këtë vizitë dhe pastaj ka shpalosur argumente të përkushtimit dhe angazhimeve për arritje në shërbim të qytetarëve duke vlerësuar lart edhe angazhimet e SBASHK-ut. Ai ka kujtuar betejat sublime të UÇK-së për liri dhe mbështetjen e madhe të SHBA-së në momentet kyçe të përpjekjeve tona për liri.



Kryetari Jasharaj është shprehur se Sindikata që përfaqëson Montgomery dhe Hernandez ishte zë i fuqishëm mbështetës për punëtorët e arsimit të Kosovës në përpjekjet e tyre sublime gjatë viteve të 90-ta. Jasharaj ka vlerësuar lart kontributin e z.McCloud në forcimin e bashkëpunimit mes sindikatave të arsimit të Kosovës, Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës.



Zëvendës presidenti i sindikatës së mësuesve amerikan z.Montgomery është shprehur i lumtur që po viziton Kosovën duke veçuar se këtu ndodhet për herën e parë. Ai ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe ka falënderuar kryetarin Aliu për mikpritjen për të treguar pastaj për përvojat e shumta sindikale në Amerikë dhe për sfidat e kohës në arsimin atje.



Mysafirët nga SHBA bashkë me përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë vizituar shkollën “Tefik Çanga” duke bashkëbiseduar me drejtorin dhe me sindikalistët këtu. Po ashtu ata ishin mysafirë në një orë mësimore dhe Montgomery është gëzuar me dijen e nxënësve të klasës së katërt me të cilët ka bashkëbiseduar në gjuhën angleze.



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Duke realizuar agjendën e ngjeshur të aktiviteteve në ditën e parë të vizitës, mysafirët nga SHBA bashkë me përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar në takime të ndara me deputetët që janë anëtarë të Komisionit Parlamentar për arsim, me Ministren e MASHTI-t Arbërie Nagavci e pastaj kishin takim solemn edhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve për ta përmbyllur ditën e parë të vizitës me deklarime për medie.



Në ditën e dytë të vizitës në Kosovë zëvendës presidenti i Sindikatës së Mësuesve të Amerikës Daniel Montgomery, drejtori për rajonin perëndimor Ramiro Hernandez, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë Steven McCloud dhe zyrtarja Kejsi Gaxha të shoqëruar nga kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, zyrtari ligjor Blendor Shatri dhe kryetari i Sindikatës komunale të Arsimit Parauniversitar në Prizren, Reshit Kushaj kanë filluar me vizitën në Prizrenin historik.



Ata fillimisht janë takuar me drejtoreshën e arsimit të kësaj komune Luljeta Veselaj-Gutaj dhe kanë bashkëbiseduar për aktualitetin në arsimin e të dy shteteve mike. Pas kësaj ata bashkërisht kanë vizituar kryetarin e Prizrenit Shaqir Totaj. Kryetari Totaj është shprehur se ndjehet i nderuar me këtë vizitë e pastaj ka kujtuar betejat e lavdishme të djemve e vajzave me emblemën e UÇK-së dhe mbështetjen e SHBA-së në realizimin e idealit të lirisë.



Zëvendës presidenti i Sindikatës së Mësuesve të Amerikës (AFT) Montgomery duke falënderuar kryetarin Totaj për mikpritjen është shprehur me respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe është shprehur se miqësia mes dy sindikatave do të vazhdojë.

Kryetari Jasharaj duke marrë pjesë në këtë bashkëbisedë ka deklaruar se mysafirët e nderuar përfaqësojnë Sindikatën që u bë zë i fuqishëm mbështetës për punëtorët e arsimit në Kosovë që në vitet e 90-ta, po bënin sakrifica sublime në ruajtjen e arsimit shqip nga furtunat e pushtuesit.





Mysafirët e kryetarit Totaj bashkë me drejtoreshën Veselaj-Gutaj kanë vizituar shkollën “Emin Duraku” duke hasur këtu në mikpritjen që është virtyt i kombit tonë. Zëvendës presidenti Montgomery pas takimit dhe

bashkëbisedës me drejtorin dhe të punësuarit e kësaj shkolle ishte mysafirë i nderuar i nxënësve. Ai u kthye në vitet e shkuara duke u bërë përsëri mësues, por tani në Kosovë. Ai me plot emocione është shprehur se këta nxënës janë të shkëlqyer. Ai ka biseduar me ta në gjuhën angleze për lëndët mësimore dhe për planet që këta fëmijë kanë për të ardhmen.



Nxënësit e kësaj shkolle duke u gjendur në pushimin e gjatë mes orëve kanë vazhduar bashkëbisedën me mysafirët në oborrin e shkollës duke bërë edhe foto e duke i përshëndetur me duartrokitje.

Në mbyllje të kësaj vizite mysafirët nga Amerika kanë ritheksuar se po shkojnë nga Kosova me përshtypje të shkëlqyera dhe krenar me miqësinë mes dy sindikatave dhe dy shteteve, miqësi që do të jetojë për jetë e mot.

## Në ditën botërore të eliminimit të punëve të rrezikshme për fëmijët **Konferencë në Tiranë “Sindikatat dhe puna e fëmijëve”**

Në Tiranë vazhdojnë të organizohen aktivitete që po dëshmojnë forcimin e bashkëpunimit mes sindikatave të arsimit të Shqipërisë, SBASHK-ut dhe sindikatave të arsimit nga disa shtete tjera të Ballkanit.



Një aktivitet i veçantë është edhe Konferenca “Sindikatat dhe puna e fëmijëve”, që u mbajt pikërisht në ditën botërore të eliminimit të braktisjes nga shkolla dhe të punëve të rrezikshme për fëmijët. Në këtë aktivitet të organizuar nga Sindikatat e arsimit të Shqipërisë kanë marrë pjesë edhe zëvendës presidentja e Internacionales Botërore të Arsimit, Marlis Tepe, zyrtari i lartë i El Samuel Grumiau, kryetari i SBASHK-ut Rrahman

Jasharaj bashkë me koordinаторin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, përfaqësues të Sindikatës së Arsimit të Malit të Zi dhe shumë kolege e kolegë nga sindikatat shqiptare të arsimit.

Kryetarët Nevrus Kaptelli e Isa Rekaj bashkë me



profesorin Xhafer Dobrushu kanë kujtuar gjithë angazhimet nëpër vite për të realizuar objektivin e ndalimit të braktisjes së shkollës dhe eliminimit të punëve të rënda të fëmijëve.

Diskutuesit kanë prezantuar përvojat nga aktiviteti disa vjeçar në përpjekje për të kthyer fëmijë që kanë braktisur shkollimin, sfidë kjo ende e pranishme në Korçë e disa pjesë të tjera të Shqipërisë.

Përfaqësuesit e SBASHK -ut kanë përgëzuar sindikalistët e arsimit në Shqipëri për gjithë këto aktivitete duke kujtuar se SBASHK në bashkëpunim me përfaqësuesen e ILO në Kosovë kanë përgatitur një program duke licencuar trajnimin “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës”



## Një shkrim që zgjoi interesim në opinion **Për hatër të Qeverisë deshta t'i zhduk 20 vitet e kaluara, por ...**

Kryetari i SBASHK-ut herë pas here u drejton medieëve shkrimet e tij që kanë të bëjnë me aktualitetin në arsim e në sindikata. Një shkrim të tillë po e bartim edhe në gazetën “Arsimimi sot” ngase zgjoi interesim në opinion. Duke parë se Qeveria Kurti vazhdon të merret me Qeveritë në 20 vitet e shkuara dhe nuk po i del pastaj kohë për të bërë as edhe një punë në shërbim të qytetarëve, vendosa t'i zhduk nga historia të gjitha ato vite dhe emrat e Kryeministrave dhe të Ministrave, por... Hapa ditarin tim dhe shkova të kujtimet që kam shënuar nga Qeveria Thaçi. Lexova faktet se pagat në arsim kishin shënuar rritje prej 116 %. Po ta zhdukja këtë pjesë atëherë pagat në sektorin e arsimit, por edhe të tërë sektorit publik do t'i ngjanin ndihmës sociale. Nuk i zhduka dot këto fletë nga ditari im.

Vazhdova tutje dhe thash hajt po zhduk fletat nga koha kur Kryeministër ishte Isa Mustafa, por jo se ai bashkë me Kujtim Shalën, Avdullah Hotin e Arban Abrashin kishin pranuar vitet e 90-ta për punëtorët e arsimit si vite kontribut dhënës, kishin implementuar shtesën prej 5% për çdo vit shërbimi që mundësonte një shtesë goxha të mirë në pagë dhe kishin bërë edhe angazhime të tjera në realizim të kërkesave të SBASHK-ut. Nuk u bë hiç të zhduk as këto faqe nga ditari im.

Shkova tutje duke shfletuar dhe tash po i bëj copë-copë fletët e ditarit nga Koha e Qeverisë Haradinaj, por nuk e bëra se po të zhdukej e mos të ishte kjo kohë atëherë punëtorët e arsimit nuk do ta kishin dot Ligjin për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës, Ligj ky që njeh atë kohë të sakrificave sublime të punëtorëve të arsimit në mbrojtje të dijes e dritës kundër errësirës që donte të mbillte pushtuesi. Ky ligj u siguron një mbështetje shtesë materiale gjithë atyre pishtarëve të dijes dhe ata janë mirënjohës e krenar për këtë. Nuk shlyhet e as nuk harrohet dot as kjo kohë e Qeverisë Haradinaj. Mendova se e ka më lehtë ta zhduk nga ditari atë

kohën e Qeverisë Hoti se zgjati fatkeqësisht më pak, por nuk e bëra dot. Ishte kjo kohë plot sfida e vështirësi që krijoi pandemia. Kryeministri Hoti me qetësi e urtësi po angazhohej në atë kohë. Na priste në takime dhe qetazi bashkëbisedonim dhe na plotësoi kërkesën për shtesën prej 100 euro në pagë. Ai bashkë me ministrin Likaj e zëvendësministrin Rexhaj u angazhuan sinqerisht dhe u nënshkrua edhe Kontrata Kolektive e Arsimit. Këto fletët e ditarit tim ruajnë vetëm disa fragmente të punës dhe angazhimeve të këtyre kryeministrave e qeverive që ata drejtonin për 20 vite dhe edhe po të kisha unë forcë magjike që të shlyeja këto do të ishte e kotë sepse ato vite kanë mbetur në kujtesën e mësuesit e të gjithë të punësuarve në sektorin publik.

Kryeministër Kurti në këtë rrugëtim kujtimesh në ditarin tim u ndala edhe të faqet që nisen më 14 shkurt e këndeje. Nuk gjeta as edhe një kërkesë të realizuar për punëtorët e arsimit, por gjeta e lexova gjithë ato deklarata ironike e fyese. Lexova gjithë ato shpifje e sharje ndaj meje e mësuesve të Kosovës nga njerëz të paudhë që kanë zgjedhur këtë stil të ulët të rrugëtimit vetëm e vetëm për të pasur dhuratë një buzëqeshje nga ju.

Këtë ditarin tim do të botoj pasi të pensionohem dhe prandaj Kryeministër dhe ju Qeveri mos e humbni kohën kot me 20 vitet e kaluara po punoni e angazhohuni sepse deri tani shumë keq qëndroni në faqet e ditarit tim.



Për hatër të Qeverisë deshta t'i zhduk 20 vitet e kaluara, por...